23/01/2026

Raporti I Ngjarjeve, 23.01.2026

Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër

Specialistët e Sektorit të Qarkullimit Rrugor arrestuan shtetasin E. H., 35 vjeç, banues në fshatin Dobraç, pasi u kap duke drejtuar automjetin, në gjendje të dehur.
Gjithashtu, specialistët e Sektorit të Qarkullimit Rrugor referuan materialet në Prokurori, pasi dje, shtetasi B. H., 54 vjeç, banues në Shkodër, duke lëvizur me biçikleti, është rrëzuar dhe për pasojë është dëmtuar. Ai po merr mjekim në Spitalin Rajonal Shkodër dhe është jashtë rrezikut për jetën.

Specialistët për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin V. K., 28 vjeç, për veprat penale "Ushtrim pa licencë i veprimtarive bankare" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale", pasi është konstatuar se ushtronte veprimtarinë e këmbimit të valutave, në mënyrë të jashtëligjshme. Gjatë kontrollit në subjektin e tij, janë konstatuar shumë parash të valutave të ndryshme, të cilat u sekuestruan në çlirësinë e provës materiale.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Shkodër referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasit L. F., 62 vjeç, dhe F. K., 58 vjeç, pasi nga kontrollet e kryera në bashkëpunim me shërbimet e OSHEE-së, në banesat e tyre u konstatuan lidhje të paligjshme të energjisë elektrike.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Malësi e Madhe referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin M. K., 25 vjeç, banues në fshatin Ormanaj, pasi gjatë kontrollit fizik, shërbimet e Policisë i gjetën një sasi lëndë të dyshuar narkotike kanabis, e cila u sekuestrua në çlirësinë e provës materiale.

Gjithashtu, specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Malësi e Madhe referuan materialet në Prokurori, pasi dje, shtetasja D. S., 44 vjeç, ka humbur jetën gjatë transportimit në spital, dyshohet për shkak të arrestit kardiak.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për veprime të mëtejshme.
–
Informacion paraprak / Rreth orës 11:20, në fshatin Koplik i Sipërm, automjeti me drejtues shtetasin K. D. është përplasur me automjetin me drejtues shtetasin J. H.

Si pasojë e aksidentit janë dëmtuar lehtë 2 drejtuesit e automjeteve dhe shtetasi K. H., pasagjer ne automjetin me drejtues shtetasin J. H., të cilët po marrin mjekim në Spitalin Rajonal Shkodër dhe janë jashtë rrezikut për jetën.

Grupi hetimor po punon për zbardhjen e rrethanave të aksidentit.

DVP Kukës

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Kukës referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin L. Sh., 42 vjeç, banues në Kukës, pasi dyshohet se në lokalin e tij organizoheshin lojëra fati. Në çlirësinë e provës materiale u sekuestrua 1 celular që dyshohet se përdoret për këtë veprimtari të paligjshme.

Gjithashtu, këta specialistë referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin L. Z., 44 vjeç, banues në qytetin e Kukësit, pasi është konstatuar se kishte ndërhyrë në rrjetin e furnizimit me energji elektrike.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë

Specialistët për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin E. Xh., pasi në dyganin e tij u konstatuan paketa cigaresh pa pullë fiskale.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 1 referuan materialet në Prokurori dhe shpallën në kërkim shtetasin D. Xh., pasi në Shkozë, dyshohet se ka goditur me grushte shtetasin E. H., për motive të dobëta.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 2 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin L. F., pasi duke drejtuar automjetin, dyshohet se ka përplasur automjetin e shtetasit A. L. dhe është larguar.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 3 arrestuan shtetasit:
-M. A., 38 vjeçe dhe R. A., 29 vjeçe, pasi dyshohet se në hyrje të ambientave të Komisariatit, kanë goditur për shkak të detyrës, një oficere policie;
-E. K., 61 vjeç, pasi dyshohet se po kryente punime ndërtime, pa leje, në një objekt, si dhe sa vendosur një derë metalike midis këtij objekti dhe banesës së shtetasit F. D., të cilin e ka kanosur. 61-vjeçari është procedues penalisht dhe më parë për të njëjtin rast;
-arrestuan shtetasin Z. H., 36 vjeç, pasi dyshohet se ka kundërshtuar me forcë punonjësin e Policisë, për shkak të detyrës.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 4 arrestuan shtetasit:
-B. M., 38 vjeç, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj djalit të tij
-A. B., 52 vjeç, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj ish-bashkëshortes së tij.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 5 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit:
-I. E., pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë psikologjike ndaj bashkëshortes së tij.
-A. P., pasi dyshohet se ka pushtuar tokën e shtetasit K. P.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 6:
-arrestuan shtetasin M. Q., 29 vjeç, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj ish-bashkëjetueses së tij;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin F. M., pasi nuk i është bindur urdhërit të punonjësit të Policisë, gjatë një procedure në lidhje me automjetin e tij;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit A. A. dhe E. Z., pasi janë konfliktuar me njëri-tjetrin, për motive të dobëta;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin I. Xh., pasi dyshohet se ka kanosur shtetasin H. M.;
-punonjë për shoqërimin e shtetasit P. B., 29 vjeç, pasi dyshohet se ka kanosur një shtetas, nëpërmjet celularit.

Specialistët e qarkullimit rrugor:
-arrestuan shtetasin R. K., 40 vjeç, pasi u kap duke drejtuar motorsipërin, në gjendje të dehur;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin Ll. N., pasi me automjetin që drejtonte, ka përplasur biçikleten me të cilën po lëvizte shtetasi M. Th., i cili ndodhet në spital, në kujdesin e mjekëve;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin Sh. S., pasi autorrëpti që drejtonte është përplasur me automjetin me drejtues shtetasin E. S. Si pasojë janë dëmtuar lehtë 2 pasagjerë;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit E. M. dhe K. P., pasi automjetet e tyre janë përplasur me njëra-tjetrën. Si pasojë është dëmtuar shtetasi E. M., i cili ndodhet në spital, në kujdesin e mjekëve.

Më datë 22.01.2026, shtetasi K. C. kallëzoi se është larguar nga banesa, dhëndri i tij, shtetasi E. S., 42 vjeç. Punohet për gjetjen e tij.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Fier

Specialistët e Qarkullimit Rrugor të DVP Fier arrestuan shtetasin A. M., 39 vjeç, banues në Fier, pasi drejtonte automjetin pa leje drejtimi dhe në gjendje të dehur.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Lushnjë shpallën në kërkim shtetasin A. L., 25 vjeç, banues në Krujë, pasi dyshohet se është autor i një vjedhjeje të ndodhur në vitin 2022, në një supermarket në qytetin e Lushnjës.

Gjithashtu, këta specialistë referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasit:
-V. V, 65 vjeç, banues në fshatin Bishqethëm, pasi ka zaptuar një sipërfaqe toke që nuk është në pronësi të tij.
-një 17-vjeçar, pasi shërbimet e Policisë i gjetën dhe i sekuestruan 2 armë sportive dhe një shufër metalike.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Fierit, për veprime të mëtejshme.

PKK Rinas

Tentoi të dalë nga Republika e Shqipërisë me 61 755 euro dhe 10 000 dollarë, pa i deklaruar sipas ligjit, procedohet penalisht 45-vjeçarja kineze.

Sekuestrohet shuma e parave.

Si rezultat i kontrolleve të imtësishme në hyrje/dalje të vendit, me objektiv parandalimin dhe konstatimin e paligjshmërive në kufi, shërbimet e Policisë Kufitare të Rinasit, në bashkëpunim me shërbimet doganore, kanë goditur një tjetër rast të mosdeklarimit në pikën e kalimit kufitar të shumave të konsiderueshme të paras.

Për këtë rast u referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal në gjendje të lirë për shtetasen A. W., 45 vjeçe, me shtetësi kineze, të cilës gjatë kontrollit në vijën e dytë iu gjetën 61 755 euro dhe 10 000 dollarë amerikanë, që synonte ti nxirte nga Republika e Shqipërisë, pa i deklaruar konform ligjit.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Korçë

Në vijim të informacionit të dhënë më datë 19.01.2026, për një konflikt fizik në lagjen nr.3, Pogradec, bëjmë me dije se shërbimet e Komisariatit të Policisë Pogradec kapën shtetasin e shpallur në kërkim për këtë ngjarje, K. N., 37 vjeç, banues në Pogradec, i cili, pas konsultimit me Prokurorin, u vendos që do të hetohet në gjendje të lirë, për veprën penale "Plagosja e lehtë me dashje", kryer në bashkëpunim.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Korçë arrestuan në flagrancë shtetasin V. Th., 40 vjeç, banues në Korçë, pasi u kap duke vjedhur vegla pune, në banesën e shtetasit Gj. O., në lagjen nr. 2, Korçë. Sendet e vjedhura u sekuestruan në çlirësinë e provës materiale.

Gjithashtu u referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasen E. C., 41 vjeçe, banuese në Korçë, pasi në muajin shkurt 2025, dyshohet se i ka marrë shtetasit Q. A., një shumë monetare, të cilën nuk ja ka kthyer, duke e mashtruar.

Specialistët për Hetimin e Narkotikëve referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasin E. B., 25 vjeç, banues në Maliq, si edhe shpallën në kërkim shtetasin R. B., 24 vjeç, banues në Maliq, pasi gjatë kontrollit në lokalin që kishin në dëshirën tij, u gjetën dhe u sekuestruan në çlirësinë e provës materiale një sasi e vogël lëndë e dyshuar narkotike cannabis sativa dhe një fenelinë si ato të Policisë. Nga verifikimet rezultoi se subjekti nuk ishte i regjistruar në organet tatimore.

Shërbimet e Sektorit të Qarkullimit Rrugor referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasit:

-R. M., 33 vjeç, banues në Pogradec, pasi në lagjen nr. 2, Pogradec, duke drejtuar automjetin, ka aksidentuar shtetasin H. E., 69 vjeç, banues në Tiranë, këmbësor, i cili u dërgua në spital dhe është jashtë rrezikut për jetën;

-një 17-vjeçar, banues në Korçë, pasi në bulevardin "Fan Noli", Korçë, ndërkohë që drejtonte automjetin, pa leje drejtimi, nuk i është bindur urdhërit të punonjësit të Policisë, për të ndaluar.

Specialistët për Hetimin Krimeve të Komisariatit të Policisë Maliq referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasin S. H., 24 vjeç, banues në fshatin Zvirinë, Maliq, pasi në fshatin Pirg, duke drejtuar automjetin dyshohet se ka prishur qetësinë publike duke shiruar gomat dhe nuk i është bindur urdhërit të punonjësit të policisë, për të ndaluar.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Kolonjë referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasit R. M., 40 vjeç dhe E. Sh., 40 vjeç, banues në Ersekë, për veprat penale "Plagosja e lehtë me dashje" dhe "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të fohtë". Këta dy shtetas dje në qytetin e Ersekës, janë konfliktuar fizikisht me njëri-tjetrin. Gjatë kontrollit fizik shtetasit E. Sh., ju gjet dhe sekuestrua në çlirësinë e provës materiale, një mjet prerës tërësi.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për veprime të mëtejshme.

Tiranë/Finalizohet operacioni i koduar "Lista".

Të kërkuar për vjedhje me dhunë, vjedhje, falsifikim kartëmonedhash dhe dhunë në familje, ndalohen 4 shtetas, ndër ta, një shtetas gjeorgjian.

Si rezultat i kontrolleve sistematike, të mbeshtetura te puna operative, me objektiv lokalizimin dhe kapjen e shtetasve të kërkuar për veprimtari kriminale të ndryshëme, struktura në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë finalizuan operacionin e koduar "Lista". Në kuadër të këtij operacioni:

-shërbimet e komisariateve të Policisë Nr. 6 dhe Nr. 3, në vijim të operacionit "Reaction", kapën shtetasin G. L., 35 vjeç (me precedent të theksuar në fyellën e vjedhjes).
Ai dyshohet se më datë 14.12.2025, në bashkëpunim me shtetasit M. A. (arrestuar menjëherë pas krimit) dhe E. H. (në kërkim), ka dhunuar shtetasin në një subjekt, për t'i vjedhur një shumë parash.
Nga hetimet ka rezultuar se i ndaluari, më datë 26.12.2025, ka vjedhur një shumë parash, në një subjekt tjetër.
Vijon puna për kapjen e bashkëpunëtorit të tij, si dhe për zbardhjen e vjedhjeve të tjera që mund të kenë kryer;

-specialistët për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare, në vijim të operacionit "Wrong Delivery", ndaluan shtetasin A. P., 20 vjeç, pasi dyshohet se në bashkëpunim me 4 shtetasit e arrestuarit gjatë zhvillimit të këtij operacioni, është përfshirë në veprimtarinë kriminale të falsifikimit të kartëmonedhave;

-shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 4 kapën shtetasin gjeorgjian, T. P., 41 vjeç pasi më datë 13.01.2026, dyshohet se ka vjedhur një shumë parash, në një tabakinë;

-shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 1 kapën shtetasin e shpallur në kërkim, për veprën penale "Dhuna në familje", M. L., 33 vjeç, pasi akuzohet se ka dhunuar vëllanë e tij.

Kontrollet vijojnë.

Materialet procedurale i janë referuar Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Tiranë/Finalizohet operacioni i koduar "Game Over 4".

Bashkëpunuan për përshtatjen e një lokali në Vaqarr, për organizim të kundërligjshëm të lojërave të fatit, arrestohen 3 shtetas, ndër ta, pronari i subjektit.

Procedohet penalisht 1 shtetas që u kap duke luajtur, në ambientet e lokalit.

Sekuestrohen 4 celularë me të cilët viheshin baste sportive.

Si rezultat i kontrolleve dhe punës operative, të kryera në zbatim të planit të posaçëm të masave "Për goditjen e veprimtarisve kriminale në fushën e organizimit të lojërave sportive online", shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 6 finalizuan operacionin e koduar "Game Over 4".

Gjatë operacionit u konstatua se 1 lokal në fshatin Vaqarr, ishte përshtatur për vënie të kundërligjshme të basteve sportive, me celularë.

Për këtë rast u vunë në pranga pronari i lokalit, shtetasi J. G., 30 vjeç, si dhe 2 bashkorganizatorët e kësaj veprimtarie të kundërligjshme, shtetasit F. D., 29 vjeç dhe K. D., 31 vjeç. Gjithashtu, u procedua në gjendje të lirë, 1 shtetas, i cili gjatë ndërhyrjes së shërbimeve, u konstatua duke vënë baste, në ambientet e lokalit, B. S., 25 vjeç.

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- Arkiva
- Akademia e Sigurisë
- Ministria e Brendshme
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- Interpol
- Europol
- Misioni PAMECA V
- SCPA
- Projekti Tivalent